PROÇESVERBAL

Nga seanca e këshillit e mbajtur me 27.07.2023 me fillim në ora 10:00, në sallën e këshillit të komunës së Zhelinës.

Seancën e hapi Kryetari I këshillit Bujar Baftijari, dhe prezantoi propozimin e rendit të ditës me nr.arkivor 08-1054/1 në përbërje prej 5 pikave.

REND DITE

1.Miratimi i proçesverbalit të Seancës së 19-të, të Këshillit të komunës së Zhelinës.

2.Ndryshimet dhe plotësimet e Buxhetit të komunës së Zhelinës për vitin 2023-të.

3.Propozim-Vendim për kriteret e përcaktimit të zonave në komunën e Zhelinës.

4.Shqyrtimi i kërkesës nr. 21-961/1 i datës 21.06.2023-të, nga SalijeEmurli nga f. Palllaticë.

5.Shqyrtimi i kërkesës nr. 08-1049/1 i datës 20.07.2023-të, nga NPK ,,MIRËMBAJTJA'' – Zhelinë

Pas prezantimit të pikave të rendit të ditës, kryetari I këshillit Bujar Baftijari, pyeti nëse dikush nga këshilltarët do ta marr fjalën. Fjalën e kërkoi këshilltari Naser Mislimi.

Naser M: Kërkoj që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë, më saktësisht ajo pikë të renditet si e treta në rendin e ditës, pra kërkoj që në rendit të shtohet një pikë pyetje për Kryetarin dhe Drejtorin e Ndërmarrjes.

Pas këshilltarit Naser M. Fjalën e mori këshilltari Bashkim Limani.

Bashkim L: Kërkoj që rendit të ditës t'i shtohet një pikë edhe atë Propozim- Vendim për dhënie pëlqim planit vjetor për punësim të shkollave fillore " Hasan Tahsini" në fshatin Rogle, dhe "Fan Noli" në fshtain Trebosh.

Kryetari i këshillit Bujar Baftjari e hodhi në votim propozimin e këshilltarit Naser Mislimi, ku me 9 vota për, asnjë kundër dhe 8 të përmbajtur konstatoi se kjo pikë i shtohet rendit të ditës.

Më pas e hodhi në votim edhe propozimin e këshilltarit Bashkim Limani, ku u votua unanimisht, dhe konstatoi se kjo pikë i shtohet rendit të ditës.

Kryetari I këshillit Bujar Baftjari Rendin e Ditës në përbërje prej shtatë pikave e hodhi në votim, u votua unanimisht.

1. Miratimi i proçesverbalit të Seancës së 19-të, të Këshillit të komunës së Zhelinës.

   Kryetari i këshillit hapi diskutim për pikën e parë të rendit të ditës, dhe meqë nuk pati diskutim këtë pikë e hodhi në votim, u votua unanimisht.

2. Pyetje për Kryetarin e komunës dhe Drejtorin e Ndërmarrjes

   Kryetari i këshillit hapi diskutim për këtë pikë, fjalën e kërkoi këshilltari Bashkim Limani i cili kërkoi një pauzë prej 15 min, që të cilën e miratuan të gjithë këshilltarët.

Pas pauzës Kryetari I këshillit së bashku me këshilltarët u dakorduan që kjo pikë të ngelet për seancën e radhës për arsye se Kryetari i komunës dhe Drejtori i Ndërmarrjes ishin të zënë me angazhime jashtë objektit të institucionit.

3. Ndryshimet dhe plotësimet e Buxhetit të komunës së Zhelinës për vitin 2023-të.

Kryetari I këshillit Bujar Baftjari hapi diskutim. Fjalën e kërkoi këshilltari ShevalSulejmani.

ShevalS: Kërkoj pak më shumë info rreth kësaj pike.

Informacione të detajuara dha AdilEmini nga Sektori për çështje financiare.

Kryetari I këshillit këtë pikë e hodhi në votim, ku me 15 vota për, asnjë kundër dhe 2 të përmbajtur konstatoi se kjo pikë kalon.

4. Propozim-Vendim për kriteret e përcaktimit të zonave në komunën e Zhelinës.
   Kryetari I këshillit dha sqarime dhe hapi diskutim për këtë pikë. Fjalën e mori këshilltarja ElmedinaZeqiri.
   Elmedina Z: Unë kam këtë propozim:
   Zona 1: 1200 denarë
   Zona 2: 800 denarë
   Zona 3: 600 denarë
   Zona 4: 400 denarë
   Zona 5: 300 denarë.
   Kryetari I këshillit Bujar Baftjari këtë pikë e hodhi në votim, u votua unanimisht dhe konstatoi se kjo pikë kalon.

5. Shqyrtimi i kërkesës nr. 21-961/1 i datës 21.06.2023-të, nga SalijeEmurli nga f. Palllaticë.

Sa i përketëkësaj kërkese sqarime dha Kryetari i këshillit Bujar Baftijari. Në kërkesën e datës 21.06.2023-të, nga Salije Emurli nga f. Palllaticë tregon se djali i saj Omer Emurli është kafshuar nga qen endacakë.

Fjalën e kërkoi këshilltari Bashkim Limani.

Bashkim L: Për këtë rast propozoj shumën 15.000 denarë.

Kryetari I këshillit këtë propozim e hodhi në votim, u votua unanimisht dhe konstatoi se kjo pikë miratohet.

6. Shqyrtimi i kërkesës nr. 08-1049/1 i datës 20.07.2023-të, nga NPK ,,MIRËMBAJTJA'' – Zhelinë

Sqarime dha Kryetari i këshillit. Fjalën e kërkoi këshilltari Naser Mislimi.

Naser M: Meqë bëhet fjalë për rastesociale është mirë që Ndërmarrja bashkë me Komunën të koordinohen me bashkësitë Lokale.

Kryetari i këshillit këtë pikë e hodhi në votim, me 8 vota për, asnjë kundër, dhe 7 të përmbajtur konstatoi se kjo pikë kalon.

7. Propozim-Vendim për dhënie Pëlqim Planit vjetor për punësim të shkollave fillore "HasanTasini" –f. Rogle, dhe " Fan Noli" – f. Trebosh.

   Kryetari i këshillit meqë nuk pati diskutim këtë e hodhi në votim, u votua unanimisht, konstatoi se kjo pikë kalon.

   Kryetari I këshillit e shpalli të mbyllur seancën e 20-të.

Nr. 08- 1054/2
27.07.2023-të
Zhelinë

Procesverbalist
Albineta Alija

Këshilli i Komunës Zhelinë
Kryetar
Bujar Baftijari